

VIDEO KONKURS

Ne besojmë se brezi i sotëm i ri mund të sjellë ndryshimin në efikasitetin e energjisë nesër. A e promovon shkolla juaj efikasitetin e energjisë duke ndihmuar në mbrojtjen e planetit?

Milieukontakt Shqipëri organizon video konkursin me temë **Efiçienca e Energjisë**.

Ftojme të rinjtë e moshave 16-26 vjeç për të krijuar video të shkurtra rreth efiçencës së energjisë dhe përfitimeve në ruajtjen e burimeve natyrore.

Si te aplikoni?

Video duhet përgatitur dhe dorëzuar nga nxënës të grupmoshave 16-26 vjeç. Mund të dorëzohet më shumë se një video nga e njëjta shkollë.

Videot duhet të kenë një kohëzgjatje deri në 3 minuta; të realizohen me pajisje cilësore dhe të jenë në gjuhën shqipe.

Videot duhet të dërgohen me email në adresën office@milieukontakt.org deri më **10 Korrik 2022**.

Vlerësimi i videove

Një grup ekspertësh vlerësues të cilët do të jenë përfaqësues të rinisë, kinematografisë dhe sektorit të energjisë, do të vlerësojnë dhe përzgjedhin 5 (pesë) videot më të mira të paraqitura për këtë konkurs. Videot e përshtatshme do të vlerësohen për rëndësinë, origjinalitetin dhe kreativitetin. Fituesit do të njoftohen përmes e-mailit në fund të muajit qershor 2022.

Çmimi parë - Bicikletë

Çmimi dytë - Tendë kampingu

Çmimi tretë - Çantë shpine

Çmimi katërt - Maskë për zhytje

Çmimi pestë - Shishe uji (termus)

Faleminderit për pjesëmarrjen dhe suksese!

Konkursi realizohet në kuader të projektit EUCENA – Akademia Europiane e Energjisë për Qytetarët, mbështetur nga nisma EUKI dhe zbatuar nga Ministria Federale e Mjedisit në Gjermani.

Partner: Bashkia Tiranë Titulli: “Kryeqyteti Evropian i Rinisë 2022”